

Komitetet për Komunitete (KK) janë mekanizma komunalë të përbërë nga përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në komunë dhe anëtarët e kuvendit të komunës. Krijimi i tyre është i detyrueshëm. Kompetencë kryesore e KK-së është shqyrtimi i të gjitha politikave, praktikave dhe aktiviteteve të komunës me qëllim rekomandimin e masave për kuvendin e komunës për të siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen.

## Dokumentet kryesore


- Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 2008;
- Udhëzimi administrativ nr. 02/2018 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë;\*
- Udhëzimet dhe Termat e referencës për komitetet për komunitete.

\* I ndryshuar dhe plotësuar në dhjetor të vitit 2020 me Udhëzimin administrativ të MAPL-së nr. 05/2020 mbi procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë. Ky UA ka hyrë në fuqi pas zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

## Themelimi

KK-të janë të themeluara në që të 38 komunat. Gjatë periudhës së raportimit, 26 KK kanë mbajtur mbledhje të rregullta të përmuajshme, tetë KK kanë mbajtur mbledhje të rregullta por më rrallë se një herë në muaj, kurse katër KK janë mbledhur jo rregullisht ose në baza *ad-hoc*.


## Përfaqësimi i komuniteteve




Çdo komunitet që jeton në komunë duhet të përfaqësohet në KK, megjithatë disa komunitete vazhdojnë të mos jenë të përfaqësuara sa duhet. Komitetet më së paku të përfaqësuara janë boshnjakët e Kosovës dhe turqit e Kosovës.

## Qasja në burime financiare\*

\* Siç është vlerësuar nga KK-të



## Përbërja gjinore



# Performanca në vitin 2021


## Treguesit e përzgjedhur të performancës

Numri i KK-ve që i kanë realizuar aktivitetet kryesore dhe detyrat themelore të përcaktuara me kornizën ligjore dhe të politikave, bazuar në monitorimin e rregullt dhe shqyrtimet periodike nga ekipet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë, si dhe raportet e komunave.


Shënim: krahasimi është bërë ndërmjet 12 muajve të vitit 2020 dhe 10 muajve të vitit 2021, si rrjedhojë e zgjedhjeve lokale të mbajtura në tetor 2021.

### 1 – Buxheti

Shqyrtimi i buxhetit të komunës




Avokimi për përfshirjen e mjeteve financiare për aktivitete që synojnë komunitetet




### 2 – Ligjëbërja dhe politikëbërja

Shqyrtimi i akteve, politikave, praktikave ose aktiviteteve tjera të komunës




Shpeshësia e dhënies së rekomandimeve në suazat e shqyrtimit të instrumenteve ligjore dhe të politikave




### 3 – Projektet

Monitorimi dhe raportimi lidhur me zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me komunitetet




### 4 – Raportimi

Përgatitja dhe dorëzimi në kohë i raportit vjetor në kuvendin e komunës



### 5 – Komunikimi dhe konsultimi

Angazhimi i komuniteteve joshumicë në hartimin e planeve të punës



## Performanca e gjithëmbarshme

Vlerësimi i performancës së KK-ve bazohet në rezultatit total të përbushjes së treguesve të performancës, që janë pasqyrim i aktiviteteve kryesore dhe detyrave themelore të parapara në kornizën përkatëse ligjore dhe të politikave. Performanca është vlerësuar si e "E lartë" kur rezultati total është mbi 66 për qind, "Mesatare" kur varion mes 66 dhe 33 për qind, dhe "E ulët" kur është nën 33 për qind.

	Buxheti	Shqyrtimi i ligjeve dhe politikave	Projekte	Raportimi	Komunikimi dhe konsultimi	PERFORMANCA E GJITHËMBARSHME
Deçan	E ulët	E ulët	Mesatare	E ulët	E ulët	16%
Dragash	E lartë	E lartë	Mesatare	E lartë	E lartë	79%
Ferizaj	Mesatare	E ulët	E lartë	E lartë	E lartë	76%
Fushë Kosovë	High	Mesatare	E lartë	E ulët	Mesatare	60%
Gjakovë	E ulët	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	43%
Gjilan	E ulët	Mesatare	Mesatare	E lartë	E lartë	52%
Gilgoc	E ulët	Mesatare	E lartë	Mesatare	E lartë	53%
Graçanicë	E ulët	Mesatare	E ulët	E lartë	E ulët	25%
Hani i Elezit	Mesatare	E ulët	Mesatare	E lartë	E lartë	57%
Istog	E lartë	Mesatare	Mesatare	E ulët	E lartë	66%
Junik	E ulët	E ulët	Mesatare	E ulët	E ulët	18%
Kaçanik	E ulët	E ulët	Mesatare	Mesatare	E lartë	37%
Kamenicë	Mesatare	Mesatare	E lartë	E ulët	E lartë	57%
Klinë	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	E lartë	64%
Klokot	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	3%
Leposaviq	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	E ulët	43%
Lipjan	E lartë	E lartë	Mesatare	E ulët	E lartë	62%
Malishevë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	94%
Mamushë	Mesatare	Mesatare	E ulët	E ulët	E ulët	28%
Mitrovicë Veriore	E lartë	Mesatare	E ulët	E lartë	E ulët	46%
Mitrovicë Jugore	E lartë	Mesatare	E lartë	Mesatare	Mesatare	64%
Novobërdë	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	Mesatare	11%
Obiliq	E lartë	E ulët	E lartë	E lartë	Mesatare	64%
Partesh	E ulët	Mesatare	Mesatare	E ulët	E ulët	21%
Pejë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	96%
Podujevë	E ulët	Mesatare	E lartë	Mesatare	E lartë	58%
Prishtinë	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	54%
Prizren	E ulët	Mesatare	Mesatare	E ulët	E lartë	34%
Rahovec	Mesatare	E ulët	Mesatare	E ulët	Mesatare	36%
Ranillug	E ulët	E ulët	Mesatare	E ulët	E ulët	22%
Shtime	E lartë	Mesatare	E lartë	E lartë	Mesatare	80%
Skenderaj	E ulët	E ulët	Mesatare	E ulët	E ulët	11%
Shtërpcë	Mesatare	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	18%
Suharekë	E lartë	E lartë	E ulët	E ulët	E lartë	47%
Viti	E ulët	E ulët	E ulët	Mesatare	E lartë	34%
Vushtrri	E ulët	E ulët	E ulët	E lartë	Mesatare	26%
Zubin Potok	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	8%
Zveçan	E ulët	Mesatare	E ulët	E ulët	E ulët	8%
<b>PERFORMANÇË MESATARE 2021</b>	<b>41%</b>	<b>39%</b>	<b>49%</b>	<b>39%</b>	<b>51%</b>	<b>44%</b>
<b>PERFORMANÇË MESATARE 2020</b>	<b>42%</b>	<b>52%</b>	<b>48%</b>	<b>45%</b>	<b>55%</b>	<b>48%</b>

Misioni i OSBE-së në Kosovë ofron mbështetje për pjesëmarrjen e shtuar të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes dhe të qeverisjes publike, si edhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, Misioni i OSBE-së në Kosovë e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim që institucioneve përkatëse t'u ofrojnë tregues që mund t'u ndihmojnë në identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.